

Ideologjitë revizioniste në dritën Islame – 2

al-Mustaqim Publications

Murxhizmi & Liberalizmi: Shpjegim i herezisë së *Irxhasë* dhe lidhja e modernistëve/progresistëve me Murxhiat

Çka është Murxhizmi?

Irxha gjuhësisht është definuar si: shpresë, zgjatje, vonim, diçka që tregon në zvarritje apo shtyrje.

Në aspektin islamik, ky term së pari u përdor ndaj një grupi muslimanësh në çështjen e mospajtimit mes Uthmanit dhe Aliut (radi Allahu anhuma). Ky grup nuk i mbajtën anë asnjërit dhe kështu kjo i paraqiti ata si të vonuar në marrjen e një qëndrimi. Pra, atyre u qe atribuar *Irxha* lidhur me këtë çështje. Ata, si grup, ishin të parët e Murxhiave (ata që kishin *Irxha*). Mirëpo, kjo hala s'përbënte herezi (bidat) nga perspektiva fetare. Bile, ata që njihen si Murxhia në kohën e tyre, asnjëherë nuk qenë në doktrinën e grupit heterodoks të njohur si Murxhia, të cilët u shfaqën më vonë, gjatë gjeneratës së dytë të muslimanëve.

Ibn Tejmije përcolli se Katade përcaktoi kohën e shfaqjes së sektit të Murxhiave të kishte ndodhur mbas revoltës së Ibn el-Esh'eth dhe pasuesve të tij¹. Ai thotë më tej:

“Personi i parë që shprehu pikëpamje Murxhite, ishte një burrë nga Medina, nga familja Hashemite, me emrin el-Hasan. Sipas (dijetarit të Hadithit) Zathanit (Ebu Amr el-Kindi, v.129H), ai erdhi të shihte el-Hasan ibn Muhamed (Ibn el-Hanefije, v.101H) dhe tha: ‘Çka është ky libër që ke shkruar?’ (Meqë ai kishte shënuar mësimet Murxhite) Ai u përgjigj: ‘O Ebu Amr, do të doja të kisha vdekur para se ta shkruaja këtë libër dhe të publikohej! Se një gabim lidhur me termin ‘iman’ (besim) nuk është si një gabim që ka të bëjë me term tjetër, siç është rasti me transmetuesit e hadithit. Në fund të fundit, domethënia e termave iman, Islam, kufr

¹ *Kitab el-Iman*, f.383.

(mosbesim) dhe nifak (hipokrizi) ka peshë në gjykimin e kësaj jete dhe të jetës së përtejme''².

Në Sheriat, *Irxha* është një koncept, një besim në vetvete, i cili ka dy parime të ndara:

1. Së pari, doktrina e Murxhizmit është besimi se veprat (apo dhe të folurit³) nuk janë pjesë e imanit (besimit)
2. Shtylla e dytë e doktrinës së *Irxhasë* është koncepti se imani as nuk shtohet e as nuk pakësohet, por është absolut; ose dikush e ka, ose nuk e ka.

Këto dy koncepte janë pikërisht baza e Murxhizmit dhe kjo ka shkallë të ndryshme. Para se të thellohemi në këtë çështje, ndjejmë se është e domosdoshme të shpjegohet doktrina e Islamit tradicional/Sunit/ortodoks. Doktrina e teologëve Sunij/selefij/Ehlul-Hadith nga koha e Shoqëruesve të pejgamberit (salallahu alejhi ue selam) deri në ditët e sotme është se realiteti i besimit ka tri komponentë:

1. Besimi/bindja në zemër (*Tesdijk bil-kalb*)
2. Të folurit me gjuhës (*Kawlu bi-lisan*)
3. Veprimet me gjymtyrë (*Amaalul bil-xhewaarih*)

Ajo çka nënkuptojnë këto tri baza është se, nëse dikush beson në një gjë, jo vetëm që do ta mbajë atë besim në zemër, por ky besim e bën të detyrueshëm të folurit me atë gjë. Kjo sepse njerëzit zakonisht nuk diskutojnë, përveç lidhur me atë në çka besojnë apo për të mbrojtur atë në çka besojnë.

Mbas kësaj, vijmë veprimet me gjymtyrë. Ajo çka nënkupton ky koncept është se, nëse dikush beson në një gjë, atëherë ai natyrisht që do ta shprehë atë besim dhe do të përdorë të folur dhe terminologji që e mbështetin atë besim. Ky besim, i cili rron

² Ibid.

³ Varësisht nga shtrirja e Murxhizmit, sepse në rrafshin e Murxhizmit ka shkallë të ndryshme, të cilat do të vihen në pah me vonë.

në zemër, përfundimisht do ta udhëzojë atë person që të kryejë vepra me gjymtyrët e trupit.

Për shembull, nëse unë përnjëmend besoj që Zoti më urdhëroi të fali namaz, atëherë natyrisht që ky besim që mbaj në zemër duhet të më detyrojë të flasë gjëra që kanë të bëjnë me të dhe t'i urdhëroj të tjerët ta kryejnë atë. Nëse shoh që të tjerët nuk falin namaz, atëherë besimi im në konceptin e namazit do të më detyrojë – si një e drejtë e besimit – t'i këshilloj njerëzit e këtillë për të falur namaz. Mbas kësaj, ngaqë besoj se Zoti ma obligoi këtë, unë përfundimisht do të shfaq besimin tim në këtë obligim duke e kryer atë me gjymtyrët e mia.

Ky koncept vërtetohet nëpërmjet parimeve themelore të logjikës, të cilat përdoren në cilëndo sferë tjetër të jetës. Një shembull i kësaj do të ishte një i punësuar në një kompani. Një kompani, zakonisht, ka rregulla të cilave punëtorët duhet t'u përmbahen, me qëllim që puna të kryhet sipas metodës së kompanisë. Nëse kompania cakton që punëtori duhet t'i buzëqeshë secilit konsumator, atëherë, nëse punëtori nuk çan kokën për këtë caktim, nga arsyeja e shëndoshë do të kuptohej se punëtori i tillë nuk do të ekzekutojë me tërë potencialin thjesht sepse sinqeritetit i punëtorit ndaj kërkesave të kompanisë është i mangët. Një mangësi e këtillë pashmangshmërisht do të bëjë që punëtori ta kryejë këtë obligim nga dëshpërimi apo nga nifaku⁴ (hipokrizia), apo kjo do të rezultojë në grindje mes punëtorit dhe punëdhënësit.

I njëjti koncept mund të përdoret në çdo sferë tjetër të jetës. Bile, dhe në rastin e bandave të rrugëve, kurdo që një anëtar vë në dyshim besnikërinë e tjetri ndaj kauzës, zakonisht thotë: "A je me ne?" apo tjera shprehje të ngjashme, për t'u siguruar se besimi i atij personi ndaj kauzës së tyre është i vërtetë. Me fjalë tjera, çdo qenie njerëzore kupton që duhet të dëshmohet e denjë për çfarëdo kauze në të cilën beson.

⁴ *Nifaku* është e kundërta e *siddk* (vërtetësisë) dhe kjo ndodh kur personi së jashtmi shfaq miratim të një gjëje të cilën së brendshmi e mohon apo e nuk e ndjen.

Pra, ishte për shkak të një morie arsyesh dhe nëpërmjet gjykimit të shëndoshë që teologët ortodoksë nga leximi themelor i Kuranit dhe i Sunetit kuptuan se besimi detyron për këto tri komponentë, në mënyrë që ai të jetë një besim i vërtetë dhe i vlefshëm. Po ashtu, të gjitha argumentet që shkojnë kundër këtyre parimeve janë dëshmuar të jenë të gabuara.

Do të përsërisim prapë se dy bazat që formojnë mendimin e *Irxhasë* apo Murxhizmit janë:

1. Ndarja nga sfera e besimit e veprave të gjymtyrëve, apo e të folurit me gjuhë, apo e të dyjave këtyre
2. Të konsiderohet se besimi as nuk shtohet, as nuk pakësohet

Për të fiksuar pikën e parë, po sjell thënien e Ebu Na'im, i cili transmeton nga Sufjan eth-Theuri, i cili tha:

“Murxhiat u dalluan nga ne në tri çështje. Ne themi që imani/besimi është thënie dhe veprime, kurse ata thonë se imani është thënie pa veprime. Ne themi që imani shtohet dhe pakësohet, kurse ata thonë që as nuk shtohet e as nuk pakësohet. Ne themi që jemi *mu'minun*/besimtarë me miratim (dmth duke thënë insha'Allah), kurse ata thonë që jemi (me garanci) *mu'minun* në sytë e Allahut...”⁵

Tani do të shqyrtohen efektet e këtyre dy koncepteve.

Rezultati përfundimtar i idesë së parë është se, kur kryhet ndonjë veprim që qet nga feja, bartësi i këtij besimi të prishur nuk bën tekfir (nuk përjashton nga Islami) aty ku tekfiri është i domosdoshëm; dhe kjo është e kundërta e Havarixhëve, të cilët konsiderojnë që çdo veprim apo shumica e shkeljeve (tejkalimeve) ekstreme e përlligjin tekfirin.

Rezultati përfundimtar i konceptit të dytë heretik qëndron në barazimin e të drejtëve me të prishurit. Dhe të dyja këto

⁵ *Hiljet el-Eulijaa*, vëll.7/29.

pikëpamje janë baza e medhhebit (shkollës së mendimit) të botës sekulare e progresiste. Ibn Tejmije tha këtë në vijim lidhur me neverinë që ngjall ky koncept:

“Refuzimi i Selefëve ndaj Murxhiave ishte përnjëmend i ashpër, meqë ata hoqën veprimet nga imani dhe thanë: ‘Sa i përket imanit, të gjithë njerëzit janë të barabartë!’ Dhe s’ka dyshim që thënia e tyre rreth njëtrajtshmërisë së imanit në çdo person është një ndër gabimet më të neveritura”⁶.

Ai, po ashtu, tha:

“Në një rast, Ibrahim en-Nekhei tha se polemika dhe konflikti i futur nga sektet e Murxhiave paraqet një kërcënim më të madh për komunitetin musliman sesa ai i Azarikitëve. Dhe, sipas ez-Zuhrit, asnjëherë s’është shfaqur ndonjë herezi (bidat) më i dëmshëm për Islamit dhe për pjesëtarët e tij sesa ai i Murxhiave”⁷.

Me fjalë tjera, në kontestin modern, ekstremizmi i progresit modern ka arritur aso përmasa me doktrinat politike si “korrektësia politike” dhe me të tjera nuanca Perëndimore, sa që është bërë mendim përgjithësisht i pranueshëm që kryerja e ritualeve të besimit personal nuk është i nevojshëm, por thjesht bindja në zemrën tënde është e mjaftueshme për atë që ti beson.

Domethënë, s’ka nevojë të mbështeten (të folurit) apo të zbatohen këto tradita a rituale (veprimi). Mirëpo, para se të zgjerohemi në nuancat moderne të *Irxhasë* siç predikohen nga grupet revizioniste, së pari do të përcjellim informata më të hollësishme për lexuesin lidhur me shkallët dhe shtrirjen e *Irxhasë* (Murxhizmit).

Në thelb, *Irxha* ishte ideja e ndarjes së veprimeve të gjymtyrëve nga imani (besimi) në zemër. Forma më e lehtë e *Irxhasë* ishte qëndrimi se imani përbëhet nga imani në zemër dhe nga të folurit me gjuhë, që është qëndrimi i Ebu Hanifes, dhe kjo është

⁶ *Mexhmu Fetawa* (5/555-556)

⁷ *Kitab el-Iman*, f.382-3.

e vetmja çështje ku ai u nda nga Imamët e tjerë në atë se imani, gjithashtu, përbëhet edhe nga veprimet me gjymtyrë.

Shejh Salih el-Feuzan thotë:

“Murxhiat janë katër llojesh:

Lloji i parë: Ata që thonë se imani është vetëm pasje njohurish rreth Allahut (*ma'rife*), pa besuar në Allahun (*tesdijk*). Ky është qëndrimi i Xhehmive dhe kjo është e folura më e përbuzur dhe më e urryer. Kjo, po ashtu, është kufr (mosbesim) në Allahun, sepse idhujtarët e moçëm, si Firauni, Hamani, Karuni, Iblisi, të gjithë ata e njihnin Allahun dhe besonin me zemër, por nuk e shprehnin atë me gjuhët e tyre e as që vepronin sipas saj me gjymtyrët e tyre. Pra, kjo dije nuk u bëri punë atyre.

Lloji i dytë: Ata që thonë se imani është vetëm *tesdijk* (besim në Allahun) me zemër. Ky është qëndrimi i Esharive dhe kjo, po ashtu, është pavërtetësi, sepse mosbesimtarët besonin në Allahun me zemrat e tyre ndërsa e dinin që Kurani dhe i Dërguari është i vërtetë. Dhe çifutët dhe të krishterët kishin njohuri rreth kësaj:

"Atyre që u dhamë Librin (çifutët dhe të krishterët) e njohin atë (Muhamedin) ashtu siç i njohin bijtë e tyre" (el-Bekare, 146)

Pra, ata besojnë me zemrat e tyre! Më i larti, lidhur me idhujtarët, tha:

"Vërtet, Ne e dimë që fjalët e tyre të vrerosin (O Muhamed). Ata (idhujtarët, keqbërësit) nuk po të mohojnë ty, por po i mohojnë ajetet e Allahut" (el-En'am, 33)

Kështu, këta njerëz nuk e shprehën besimin me gjuhët e tyre e as që kryen vepra me gjymtyrët e tyre sipas besimit që kishin, kështu që ata nuk qenë besimtarë të vërtetë.

Lloji i tretë: Këta janë Keramitët, e kundërta e ideologjisë Esharite; ata që thonë se imani shprehet me gjuhë, por pa besuar me zemër. S'ka dyshim që kjo e folur është pavërtetësi, sepse munafikët (hipokritët), ata që do të jenë në shtresën më të ulët të Zjarrit, thonë: "Dëshmojmë se askush s'meriton të adhurohet, përveç Allahut, dhe se Muhamedi është i Dërguar i Tij" me gjuhët e tyre, por nuk besojnë në këtë dhe nuk e konfirmojnë me zemrat e tyre, siç tha më i larti:

"Kur të vijnë hipokritët të ti (O Muhamed), thonë: 'Dëshmojmë se ti vërtet je i Dërguar i Allahut'. Allahu e di që ti je i Dërguar i Allahut dhe Allahu dëshmon se hipokritët janë gënjeshtarë. Ata i kanë bërë betimet e tyre mbulesë (për hipokrizinë e tyre) dhe i pengojnë njerëzit nga rruga e Allahut. Vërtet, e ligë është ajo çfarë ata bënin" (el-Munafikun, 1-2);

"... e thoshin me gojët e tyre atë që s'ishte në zemrat e tyre" (Aali Imran, 167)

Lloji i katërt: Këta janë grupi me shkallën më të ulët të *Irxhasë*, ata që thonë se imani është besim me zemër dhe shprehje me gjuhë, por veprat (e gjymtyrëve) nuk hyjnë në këtë. Ky është qëndrim i *murxhietu-fukaha*, dhe kjo, po ashtu, është e pasaktë".

Para se të vazhdojmë me manifestimet moderne të kësaj *Irxhaje* ekstreme, do të përcjellim disa detaje të ndërlikuara mbi aspektin e besimit karshi herezisë së *Irxhasë*, të cilat i kanë qartësuar teologët islamikë, dhe do të ndërhyhet vetëm aty ku besojmë se duhet sqaruar më tej për lexuesin.

Ebu Hasan el-Eshari e thotë këtë në vijim lidhur me Murxhiat ndër bashkëmendimtarët e Bishr el-Marisit:

"el-Marrisije: sekti i njëmbëdhjetë nga Murxhiat përfaqëson pasuesit e Bishr el-Marisit të cilët thonë: 'Imani është vetëm besim (*tesdijk*), sepse imani gjuhësisht i referohet vetëm

bindjes/vërtetimit me zemër, dhe çfarëdo që s'është vërtetim me zemër (*tesdijk*), nuk mund të jetë iman'.

Ai pohoi se *tesdijk* (bindja e zemrës, besimi) ndodh në zemër dhe në gjuhë. Kjo, po ashtu, ishte pikëpamja e Ibn el-Rewendit. Ibn el-Rewendi besonte se kufri (mosbesimi) është mospranim (*el-xhehd*), refuzim (*el-inkar*), fshehje (*es-Setr*) dhe mbulim (*et-taghtiye*). Kufri s'mund të jetë tjetër përveç kufrit në kuptimin gjuhësor, dhe po kështu imani s'mund të jetë tjetër përveç çka konsiderohet iman në kuptimin gjuhësor".

Sido që të jetë, Ibn Tejmije e qartëson realitetin e Murxhiave dhe ajo në çka ata besojnë duke thënë:

"Murxhiat – me krejt sektet e tyre të ndryshme – pohojnë se bërja e gjynaheve të mëdha dhe lënia e detyrave të jashtme nuk bëjnë që imani të pakësohet. Meqë, nëse një pjesë e saj do të ikte, s'do të mbetej gjë prej tij. Ndaj, ai (imani) s'është tjetër veçse një entitet i vetëm! Gjynahqari dhe i drejti janë të barabartë sa i përket atij (imani)"⁸.

Sa i përket realitetit të besimit të tyre, nxisim lexuesit t'i kushtojnë vëmendje diskutimit vijues nga Imami i nderuar Ebu Ubejd el-Kasim bin Sel'lam, i cili shpjegon imanin si më poshtë. Në *Kitab el-Iman*, f.28-29, ai shpjegon:

"Imani ka shkallë dhe grada, edhe nëse njerëzit i quajnë me një emër. Sigurisht që ai është vepër nga veprat me të cilat Allahu i nënshtroi robërit e Tij dhe e bëri të detyrueshme për gjymtyrët e tyre. Rrënjën e tij (imani) Ai e bëri në njohurinë e zemrës, pastaj të folurit e bëri dëshmi për të, pastaj veprat vërtetim të tij. Padyshim që Allahu çdo gjymtyrë i dha një vepër të cilën nuk ia dha tjetrës. Kështu, vepra e zemrës është besimi, vepra e gjuhës është thënia, vepra e dorës është pranimi, vepra e këmbës është të ecurit, dhe emri 'iman' i përmbledh të gjitha këto. Pra, imani, sipas këtij kuptimi, i tëri është ndërtuar mbi veprim, nga fillimi i tij deri të mbarimi i

⁸ *Mexhmu Fetawa* (7/223)

tij, përveçqë ai konkurren për gradë më të lartë sipas asaj që përshkruam.

Ai që na kundërshton (dmth Murxhia) pohoi se të folurit është pa veprim. Kështu, sipas neve, kjo është kontradiktore, sepse sikur ai ta konsideronte iman të folurit, atëherë ai do të vërtetonte që të folurit është vepër, dhe ai s'është i vetëdijshëm për çfarë ju informova nga shkaqet imagjinare në të quajturit e punëve të gjymtyrëve si veprim tek arabët.

Vërtetimi i veprës së zemrës dhe të gjuhës si iman gjendet në interpretimin e Librit (Kuranit), siç është thënia e Allahut të madhërishëm lidhur me zemrën:

'Përveç atij që shtrëngohet ndërsa zemra e tij është e sigurt në iman' (16:106);

'Nëse ju të dyja i ktheheni me pendim Allahut, pasi zemrat e ju dyjave qenë përkulur...' (66:4);

'Ata që, kur të përmendet Allahu, zemrat e tyre frikësohen' (22:35).

I Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selam) tha:

'Vërtet, në trup është një copë mishi. Nëse ajo është e mirë, edhe pjesa tjetër e trupit do të jetë e mirë. Kjo është zemra'.

Nëse një herë zemra është e sigurt, pastaj herën tjetër përkulet, pastaj herën tjetër frikësohet, pastaj prej saj dalin drejtësia e prishja, atëherë cila vepër është më e madhe se kjo? Pastaj, përmendim dhe thënien e Tij: 'Dhe ata thonë më vete: Pse nuk na dënon Allahu për atë çfarë flasim?' (58:8) Pra, kjo kishte të bënte me veprimin e zemrës.

Sa i përket veprimit të gjuhës, është thënia e tij: 'Ata mund të fshehin nga njerëzit, por s'mund të fshehin nga Allahu. Ai është me ta, kur ata komplotojnë me fjalë me të cilat Ai s'është i kënaqur. Dhe Allahu përfshin gjithçka që ata bëjnë' (4:108). Pra, Allahu përmendi të folurit dhe e quajti vepër.

Pastaj, Ai tha: 'Nëse ata të mohojnë, thuaj: 'Unë kam veprat e mia dhe ju keni veprat tuaja. Ju jeni të lirë nga ajo çfarë bëj unë dhe unë jam i lirë nga ajo çfarë bëni ju' (10:41) A ishte veprimi i të Dërguarit të Allahut ndaj tyre gjë tjetër veçse thirrje e tyre për të Allahu dhe refuzimi i tyre ndaj tij një thënie mospranimi, dhe Allahu këtë e quajti vepër? Dhe Ai e tha këtë në vend tjetër: 'Një folës prej tyre tha: Vërtet, unë pata një shok që thoshte: 'A je ti prej atyre që vërtetojnë (besojnë në ringjallje)?' deri te 'për një gjë të tillë le të veprojnë vepruesit' (37:51-61). Kështu, a bëhet vërtetimi me tjetër përveç të folurit, ndërsa Ai shokun (folësin) e tij e quajti veprues?! Pastaj Allahu tha: 'Punoni me falënderim, o familja e Daudit' (34:13). Pra, ajo çfarë në të shumtën e rasteve te njerëzit njihet si falënderim, është lavdërimi dhe mirënjohja me gjuhë, ndonëse edhe shpërblimi mund të quhet falënderim.

Kështu, tërë këtë që e interpretojmë, sigurisht që është sipas domethënies së fjalëpërfjalshme të Kuranit dhe nga ajo që dijetarët kanë interpretuar. Dhe Allahu është më i dijshtëm për atë çfarë Ai ka synuar (me këto ajete)"⁹.

Ibn Tejmije përmend thënien e shkëlqyeshme të Sehl bin Abdullah et-Tusetrit lidhur me imanin, kur ai qe pyetur: "Çka është imani?", dhe ai u përgjigj:

"(Imani është) Të folur, veprim, nijet dhe Sunet. Nëse imani është të folur pa veprim, atëherë ajo është kufr (mosbesim). Nëse ai është të folur dhe veprim, por pa nijet, ajo është nifak (hipokrizi). Dhe, nëse ai është të folur, veprim dhe nijet, por pa Sunet, atëherë është bidat (herezi)"¹⁰

Ky është mishërimi dhe pikërisht thelbi i imanit. Nëse imani është diçka që vetëm flitet dhe asnjëherë nuk pasohet me veprim, atëherë këto, siç thonë, janë llafe të kota dhe, në parim, kjo është kufr.

⁹ *Kitab el-Iman ue Me'alimih ue Sunenih uestikmalih ue Deraxhatih*. Bejrut, Liban: Mekteb el-Islami, 1983, f.28-29.

¹⁰ *El-Iman*, f.172.

Nëse imani konceptohet si të folur dhe veprim, por nuk është diçka në të cilën zemra është e bindur, atëherë kjo është hipokrizi e plotë, dhe hipokrizia, siç kuptohet nga Sheriati i Islamit, është që së jashtmi të shfaqësh besim, qoftë nëpërmjet të folurit apo veprimit, për të cilin së brendshmi zemra nuk është e bindur. Në thelb, kjo është shkalla e skajshme e pandershmërisë dhe antitezë e së kundërtës së saj, që është *es-Sidk* (vërtetësia).

Në fund, nëse imani ndërtohet nga të folurit së bashku me veprim dhe, gjithashtu, me nijet (besim në zemër), por s'është në përputhje me metodologjinë pejgamberike, atëherë ky iman bëhet një lloj bidati më parë sesa një rrezatim i imanit, meqë imani i vërtetë realizohet përfundimisht atëherë kur të plotësohen katër kërkesat e tij, të cilat janë shpjeguar nga teologët islamikë e që janë: të folurit, veprimi, nijeti dhe që krejt kjo të jetë në përputhje me metodologjinë e pejgamberit (salallahu alejhi ue selam).

Për të përmbledhur këtë aspekt të kësaj teme, do të sjellim edhe dy autoritete të respektuara për të plotësuar argumentin.

Imam esh-Shafi'i thotë, siç është transmetuar nga Ibn Tejmije:

“Njëzëshmëria e Sahabëve, e Tabi'inëve dhe e kujtdo pas tyre, si dhe e atyre që i takuam (lidhur me imanin) ishte se imani është të folur, veprim dhe nijet; dhe njëra nga këto s'mund të ekzistojë, përveç së bashku me të tjerat”¹¹.

Definicioni i Imam Muhamed ibn Abdul-Wehabit është si në vijim:

“S'ka dallim në qëndrime lidhur me të qenit e teuhidit në zemër, në gjuhë dhe në vepra. Dhe, nëse njëra nga këto nuk ekziston, personi s'mund të jetë musliman. Nëse personi e njeh teuhidin, por nuk vepron sipas tij, atëherë ai është dikush që ka kufrin e kokëfortësisë (*kafir mu'anid*), si kufri i Firaunit, i Iblisit dhe i të ngjashmëve me ta”¹².

¹¹ *Mexhmu el-Fetaua*, vëll.7/309.

¹² *Keshf esh-Shubuhah*, f.40.

Çka është *Irxha* në kohët moderne

Është tepër e rëndësishme që të shpjegohet hollësisht se çka saktësisht është *Irxha* në kontekstin modern. Pse? Thjesht bazuar në atë se pothuaj tërë edukatorët dhe ideologët islamikë të cilët kanë shpjeguar Murxhizmin apo *Irxhanë* në cilindo punim apo ligjëratë të tyre, e kanë lënë këtë term në formën e transkriptuar, siç edhe mund të shohë lexuesi se termi "*Irxha*" apo "*Murxhia*" nuk është përkthyer, por vetëm janë sqaruar konceptet e saj ndërsa kjo s'është bërë me vetë termin. Kjo meqë asnjë historishkrues apo teolog musliman nuk e ka përkthyer formalisht këtë term për përdorimin terminologjik modern.

Kështu, pasi po përballemi me këtë fenomen, unë do të shtie një përkthim real të termit "*Irxha*" dhe "*Murxhia*". Mbase të përkthej termin dhe të shpjegoj arsyen për përdorimin e ekuivalentit të këtyre termave në anglisht/shqip dhe mbase t'i parashtrojmë arsyet dhe t'i shpjegojmë ato, lexuesi do të mund të pranojë apo të refuzojë përkthimin e këtyre termave.

Mbas vite debatesh akademike dhe nganjëherë jo dhe aq akademike me grupe modernistësh, me refuzues të Hadithit e bile dhe me "muslimanë" që anojnë nga sekularizmi, mu desh të nxirrja një përfundim mbi çështjen e *Irxhasë* dhe të Murxhiave. Para se të shpjegoj përkthimin e tyre, më duhet së pari që të shpjegoj dy termat. *Irxha*, nga aspekti doktrinar, është koncepti, ndërsa termi "*Murxhia*" është përfaqësimi i ithtarëve të saj. Sepse, kur ndajshitesa arabe "mu" t'i shtohet një veprimi (foljes), atëherë kjo tregon në "atë që e bën atë gjë". Prej këtui, termi "*Murxhia*" është shprehje gjuhësore për njerëzit që mbështesin atë besim, ndërsa termi "*Irxha*" është vetë besimi apo koncepti. Më lart në këtë kaptinë, "*Irxha*" është përkthyer si koncepti i Murxhizmit.

Në çdo rast, mbas vitesh angazhimi në këtë fushë me revizionistë dhe me antagonistë jomuslimanë, erdha në përfundim se termi ekuivalent modern, i përshtatshëm për përkthimin e termit "*Irxha*", përfundimisht është fjala "liberalizëm". Ndaj, "*Murxhiat*", në ekuivalentin e tij modern

në anglisht/shqip logjikisht apo, thënë më mirë, nga aspekti leksikor, do të përkthehet si “liberalët”.

Përse u zgjodh ky term? Me qëllim që muslimanët të kuptojnë përse u zgjodh ky term, ata duhet të studiojnë dhe të hulumtojnë ideologjitë liberale që janë dalë nga kultura evropiane në të kaluarën dhe mënyrën sesi përparuan ato deri tek mendimi ideologjik modern. Kurse, që akademikët jomuslimanë të kuptojnë zgjedhjen e bërë në përdorimin e “liberalizmit” si ekuivalent modern të termit “*Irxha*”, ata duhet të studiojnë dhe të shqyrtojnë përplasjet e hershme islamike mes teologëve ortodoksë dhe heterodoksë rreth kësaj çështjeje.

Faktorët e ndryshëm që më çuan në këtë zgjedhje gjatë përpjekjes për të përcjellë një ekuivalent modern perëndimor se çka përfaqëson koncepti i *Irxhasë* si term, janë pikat në vijim.

1. Në aspektin konceptual, liberalizmi përftohet nga termi (Ang.) “liberate” (Shqip: të lirosh; të çlirosh). “Liberal” dhe “liberalizëm” janë forma të avancuara të termit bazë “liberate”, e po kështu dhe fjala “liberty” (Shqip: Liri). Domethënia kryesore e termit “liberate” është: të lirosh, si nga burgimi apo prangosja. Antonimi i këtij termi është: burgosje; skllavërim.

Sa i përket konceptit etik të përdorimit të këtij termi, qëllimi i ideologjisë liberale është të çlirojë njerëzit nga prangat e autoritetit, kryesisht të ushqyer nga ndjeshmëria evropiane, për shkak të natyrës dogmatike të fesë së tyre. Thënë shkurt, mendim liberal, siç përdoret në kontekstin fetar sa i përket Perëndimit, do të thotë t’u lejohet njerëzve të shprehin lirshëm mendimet e tyre, pa u prangosur apo pa u dashur të përballen me ndonjë ndëshkimi nga autoritetet, qofshin ato mendime politike apo fetare, por në më shumë raste kemi të bëjmë me ato fetare. Pra, me këtë është menduar të hiqet pushteti/mundësia e cilitdo autoriteti fetar për të dëmtuar këdo që ai autoritet fetar e konsideron të jetë një person që ka bërë shkelje të rënda ndaj teologjisë së tij.

Domethënia kryesore e një liberali është: “Favorizues i progresit dhe i reformës, si në çështjet politike apo fetare”.

Rezultati përfundimtar i zbatimit të liberalizmit është pushtetit i plotë i njerëzve për të bërë çfarë të duan, si të duan dhe kurdo që të duan, dhe, megjithëkëtë, t’i mbeten besnikë një feje. Sepse feja për ta është ashtu siç e shohin ata më parë sesa siç Zoti i tyre nxiti apo obligoi të jetë.

Shkurt, sa i përket besimit, liberalët mendojnë se ata mund të jenë “besimtarë të devotshëm” ndërsa kanë sjellje dhe pikëpamje të pamoralshme, dhe se një sjellje e tillë nuk mund ta pengojë, ta pakësojë apo dhe ta zhvlerësojë besimin e tyre, dhe se besimi i tyre nuk zvogëlohet me këtë sjellje të pamoralshme (*faahisha, mufasid*, etj.)

Lidhja e këtij koncepti me Murxhiat e moçëm në historinë islamike është 100 % identike. Murxhiat në historinë islamike kanë konsideruar se njerëzit mund të kenë besim të përsosur, pavarësisht se ata bëjnë paturpësi/gjynahe. Pse? Sepse gjithçka kthehej te doktrina se veprimi s’ka kurrfarë rëndësie ndaj besimit, prandaj dhe është e shqitur prej tij.

Logjikisht, kur besohet në këtë doktrinë, kjo ithtarëve të vet u jep idenë se, meqë veprat s’janë pjesë e fesë, atëherë kjo do të thotë se njerëzit mund të bëjnë çfarë të duan dhe hala të kenë hise në besim.

Kjo nënkupton se njerëzit mund të kryejnë veprime të liga dhe kjo të mos ua pakësojë besimin apo ta bëjë atë të mangët. Nga aspekti ideologjik, konkluzioni im për ligj faktin se Murxhiat janë ngjyrim perëndimor i liberalëve.

2. Së dyti, ideologjia liberale e jomuslimanëve është saktësisht e njëjtë me ideologjitë revizioniste të modelit islamik dhe pikërisht si Murxhiat e moçëm. Të tria këto grupime i kushtojnë shumë pak ose s’i kushtojnë kurrfarë

rëndësie aspektit etik të kryerjes së veprave, por të tria këto theksojnë apo prekin "të drejtën" që njerëzit kanë për të praktikuar aspektin amoral të kryerjes së veprave.

Edhe ideologët revizionistë modernë, edhe gjyshërit e tyre nga Murxhiat e kaluar kanë argumentuar për ndryshimin e teksteve që bien ndesh me pikëpamjet e tyre; Murxhiat duke u kundërshtuar me tekstet që kanë të bëjnë me imanin, ndërsa revizionistët e sotshëm argumentojnë bazuar në atë se ata munden të mbeten muslimanë të devotshëm ndërsa nuk kryejnë veprat e mira (që i shohin si problematike) dhe po kështu argumentojnë rreth teksteve që bien ndesh me pikëpamjet e tyre moderniste. Dallimi i vetëm mes revizionistëve të ditës së sotme dhe Murxhiave të moçëm qëndron në atë se revizionistët kanë një mori çështjesh me të cilat kanë problem sa i përket Islamit, kurse Murxhiat e moçëm u kufizuan në sasinë e çështjeve islame me të cilat kishin problem.

3. Arsyeya kryesore për këtë përkthim (Murxhia = liberal) është se kjo doktrinë e *Irxhasë* në Islam, po ashtu, ndodhi dhe në reformën Protestante, e cila është bastion i ideologjive liberale në rrafshin e krishterë. Citatet në vijim do të jenë të vetëkuptueshme për lexuesin, por, megjithatë, do t'i qartësojmë disa gjëra më tej.

Gjatë kulmit të reformës, nga Johanes Tauler i Strasburgut erdhi ideja mistike e "fesë së zemrës", e cila e çoi doktrinën Luteriane në "justifikimin nëpërmjet besimit". Kjo doktrinë, me të cilën erdhi Martin Luteri, ishte nisma e *Irxhasë* (ndarjes së veprave nga realiteti i besimit) për Kishën e krishtere. Para tij, teologë të ndryshëm të krishterë adresuan domosdoshmërinë e veprave si një manifestim i nevojshëm i besimit, gjë që, në parim, është ajo çka shprehën teologët islamikë; natyrisht që me pikëpamje të ndryshme. Sidoqoftë, po mund të kuptohet mendimi i njëjtë. Do të këqyrim se si u ballafaquan të krishterët e hershëm me problemin e Murxhizmit në fenë e tyre.

James (Xhejms): 2:15-18: "Ta zëmë se një vëlla apo një motër s'ka tesha dhe ushqim. Nëse dikush prej jush i thotë: 'Shko. Kalofsh mirë. Mbahu ngrohtë dhe ushqehu mirë', por nuk bën gjë për nevojat fizike të tij, çfarë mirësie do të ishte kjo? Po kështu, vetëm besimi, nëse nuk shoqërohet me veprim, është i vdekur. Dikush do të thotë: 'Ti ke besim, unë kam vepra'. Ma trego besimin tënd pa vepra, dhe unë do të ta tregoj besimin tim me atë çfarë bëj". (James 2:15-26 Faith and Works/Besimi dhe veprat)

D. Kennedy e shpjegon këtë varg:

"... Xhejms po ballafaqohet me njerëzit që pretendojnë të jenë të krishterë, por që nuk e dëshmojnë besimin e tyre me anë të punëve (veprave). Prapë dhe vazhdimisht... njerëzit thonë se besojnë, por nuk punojnë, dhe Xhejms po thotë se besimi i vërtetë gjithmonë rezulton me punë ... Shtrohet pyetja: 'Një person thotë se beson, por a do ta justifikojë atë ky besim?' Nëse kjo është vetëm një besim 'i thënë' (vetëm llaf goje), jo, s' do ta justifikojë!"
(Justification by Faith/Justifikimi nëpërmjet besimit – What about James 2:24?)

Është pikërisht kjo doktrinë, e cila jo vetëm që ndikoi në përhapjen e sekularizmit, por u bë dhe bazë për pikëpamjen e fesë në botën perëndimore.

Manifestime moderne të *Irxhasë* (besimeve liberale)

Nën këtë nënkapitull, duam të përmbledhim pika të ndryshme bashkëkohore të përdorura nga muslimani i thjeshtë i sotëm, i cili në mënyrë indirekte është ndikuar nga *Irxha* (besimet liberale) apo nga vetë revizionistët të cilët, në fakt, përfaqësojnë pikëpamjet heretike të *Irxhasë* të Islamit të kaluar.

1. Pohimi i parë, zakonisht, bëhet nga femrat që nuk mbulohen. Atyre u pëlqen të mbrojnë këtë paturpësi me shprehjen:

“Hixhabi i vërtetë është hixhabi i zemrës”.

Ajo çka nënkupton kjo thënie është se, ajo që i intereson Zotit, është ajo çfarë fsheh zemra, kurse gjithçka tjetër jashtë zemrës është e parëndësishme.

2. Një tjetër realitet semantik i cili po bën që muslimanët të paguajnë shtrenjtë, në fakt, është një zgjatim i vullnetit Perëndimor, i cili ilustron me shembullin në vijim:

“Lëri njerëzit të bëjnë si të duan”.

Kjo thënie është pishtar dhe simbol i “modernizmit” dhe, mbi të gjitha, i “tolerancës” në botën e sotme deri në atë masë, sa që kjo është bërë ADN-ja e të kuptuarit të njerëzve.

Kjo thënie thuhet vetëm nga njerëzit që janë të shkujdesur ndaj thelbit dhe realitetit si të veprave, ashtu dhe të imanit, në atë se lejimi i së keqes nënkupton përhapjen e çoroditjes, dhe lejimi e përhapja e së keqes nënkupton dëmtimin e besimit të njerëzve.

Islami ka refuzim direkt të kësaj ideologjie në hadithin e Safinës, të transmetuar nga Sahih el-Buhari në kaptinën e ortakërisë nga Nu'man bin Beshir se peygamberi (salallahu alejhi ue selam) tha:

“Shembulli i atij që ngrihet për fenë e Allahut dhe i atij që e lë atë është si shembulli i njerëzve në një anije, disa nga të cilët vendosen në kuvertën e epërme dhe disa në kuvertën e poshtme. Sa herë që ata në kuvertën e poshtme kanë nevojë për ujë, u duhet të shkojnë në kuvertën e epërme për ta marrë atë. Kështu, disa prej tyre thonë: ‘Përse nuk e bëjmë një vrimë në kuvertën tonë, që të mos i bezdisim njerëzit e kuvertës së epërme?’ Nëse njerëzit nuk i ndalin këta, ata të gjithë do të mbyten; nëse i ndalin, të gjithë do të shpëtojnë”.

Ky hadith, po ashtu, është përcjell në një tjetër transmetim, ku pejgamberi (salallahu lejhi ue selam thotë):

“Shembulli i atij që ngrihet për të drejtat/*Hudud e Allahut dhe atij që bën kompromise me hududed e Allahut ...*”

Hadithi është i vërtetë dhe ka shumë transmetime. Pejgamberi (salallahu alejhi ue selam) na dha këtë shembull duke na shpjeguar realitetin e njerëzve në shoqërinë ku jetojnë dhe rolin e tyre në të. Hadithi përmend faktin se njerëzit në cilëndo shoqëri duhet të jetojnë së bashku dhe të durojnë njëri-tjetrin, se çdo popull ka nevojat e veta, siç ishte nevoja e njerëzve të kuvertës së poshtme për të marrë ujë. Shembulli i anijes është si njerëzit në një shoqëri, ku disa njerëz duan të bëjnë vepra të këqija duke bërë vrimën në fund të anijes, dhe ky hadith shpjegon se njerëzit e kuvertës së epërme ose duhet të kryejnë punën e tyre e t'i ndalin ata, ose, nëse i injorojnë ata dhe krizën, atëherë të gjithë do të përballen me shkatërrim.

Pra, ky hadith na mëson se s'ka shoqëri të pastër nga e keqja dhe prishja, dhe çdo person i prishur justifikon prishjen me çfarëdo argumenti, qoftë duke pohuar se “po ua lehtëson të tjerëve”, qoftë se ajo është “modernizëm” apo “liri”.

Ndaj, njerëzit në atë shoqëri duhet t'i pengojnë ata nga prishja dhe të shpëtojnë çdonjërin nga hidhërimi i Allahut. Nëse dështojnë ta bëjnë këtë, hidhërimi i Allahut dhe ndëshkimi i Tij do ta mbërrijë çdonjërin. Allahu i patëmeta thotë:

“Kini frikë dënimit që s'do t'i godasë vetëm të padrejtit mes jush, dhe dini se Allahu është i ashpër në dënim”. (el-Enfal, 25)

Hadithi thotë se ka njerëz që duan të ngrihen për *hududed* (të drejtat) e Allahut dhe ka njerëz që duan të bëjnë kompromis me to. Pejgamberi (salallahu alejhi ue selam) tha:

“Nëse njerëzit e shohin një keqbërës dhe nuk e ndalin, dënimi do t’i mbërrijë të gjithë”.

Të këtillë janë njerëzit e Islamit dhe të Sunetit, të cilët ruajnë të drejtat e Allahut, dhe revizionistët të cilët anojnë nga shkatërrimi i të drejtave të Allahut fuqimadh.